



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e trembëdhjetë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **30.03.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negidet Ramaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdije Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 23. <u>Qerim Rexhaj, VV;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 26. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: https://www.youtube.com/watch?v=kP_nbw4TeE8&t=1s, <https://www.youtube.com/watch?v=o8AhfwvUWTA&t=64s> : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes njëzet e pesë (26) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
3. Shqyrtimi i Raportit të Planit të efikasitetit për vitin 2022.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2022.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private.
6. Korrigjimi i Planit të Veprimtimit për Transparencë.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit të nenit 3 të Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoha.
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi?

Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati - përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që në rend dite të hy si pikë, Plotësimi i emrit të projektit “Ndërtimi i Infrastrukturës së Jashtësme në shkollën “Mithat Frasheri” në Gurrakoc ” me emrin e ri të projektit “Ndërtimi i Infrastrukturës së Jashtësme, Fasadimi, Ndërrimi i Dyerve dhe Dritareve në shkollën “Mithat Frasheri” në Gurrakoc”.

Drejtori i Administratës z. Arben Kabashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Formimit të komisionit për themelimin e këshillave të fshatrave.

Kryesuesi i Kuvendit – hedhe në votim, pikën e rendit të ditës
Miratohet unanim nga anëtarët e kuvendit,

Pasi që nuk ka tjera propozime

Hedh në votim rendin e ditës

Miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje unanim nga anëtarët e Kuvendit.

Konstatohet që me 26 anëtar janë prezent

2

Procesverbali

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhje mungojnë: Melis Smakic i cili ka lajmëruar për arsye familjare nuk mund t marr pjesë n mbledhje, për shkaqe shëndetësorë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Pasi q nuk keni diçka,

Hedh në miratim

Miratohet unanim

Konstatohet që me 26 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 30.03.2023 pa vërejtje.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e radhës, Shqyrtimi i Raportit të Planit të efijencës për vitin 2022. A ka dikush diçka?

Udhëheqësit për Efijencë të Energjisë z. Isa Hoxhaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Raportit të Planit të efijencës për vitin 2022.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, këto projekte janë planifikuar gjatë vitit 2019 dhe 2020 por për shkak të pandemisë nuk kanë mundur të realizohen dhe janë bartur, nga shkollat që nuk kanë mundur me u realizuar kanë qen shkollat në trubohoc, Dubrava, Tuqep etj. Projektet kanë dështuar e ka thënë edhe drejtori por dua ta di arsyen pse kanë dështuar këto projekte.

Përzgjedhja e këtyre projekteve aktuale është me vend sepse kursimi i energjisë është i vlefshëm.

Ndriçimi publik kemi pak telashe, ndriçimet publike zakonisht mbikëqyren nga kompanitë private ku shumica e poqavë nuk funksionojnë është mirë që këto poqa të ndërrohen kemi ndriçimin me natrium ka me pak dritë por shpresoj që të zëvendësohen dhe mos të punohet më me poqat led. Ndriçimi publik Smart sa ka mundësi komuna që kjo me u zbatuar në ndonjë rrugë apo pjesë të qytetit.

Udhëheqësit për Efijencë të Energjisë z. Isa Hoxhaj – përgjigjet në pyetjet dhe sqaron.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush te shtoj diçka rreth këtij raporti. Pasi që nuk ka diskutime tjera.

Kalojmë në piken tjetër.

25 anëtar prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2022.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osman Sadikaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Raportit financiar për vitin fiskal 2022.

Niman Beqiraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, raporti është i njëjtë si çdo vite i pagave mëditjeve, drekave zyrtare udhëtimeve të shpeshta buxhet i nartit të shëtitjeve që shumë pak e ka pasur në fokus qytetarin p.sh në baze të raportit thuhet që shpenzimet për udhëtime brenda dhe jashtë vendit janë mbi 86 mijë karburant për vetura 90 mijë euro pa llogaritur naftën për nxëmë qendrore dhe për gjenerator, këto i bie dikund nga 250 euro naftë në ditë. 29.500 euro dreka zyrtare . suficit i kemi pasur mbi 1 milion ku është problemi me këtë mbetje kaq të madhe të suficitit sidomos të projektet kapitale. A e keni ber mekanizmin për me i zgjidhur këto probleme, ndërkaq të neni 18 detajet apo detyrimet kontingjente dëmtim kompensim demi e terma të ngjashëm mirë këtë fjalën kthim borxhi çfarë borxhi ka komuna personit privat p.sh Milaim Maraj kthim borxhit 250 mijë euro këtu nuk ka as një sqarim pse ky borxh a keni qenë muzikë live apo fallugja çfarë është ky borxh.

Kryetari i Komunës – po akuzon po rrini në troftë po shkoni në muzikë. Niman ke qenë i njoftuar me çmimin e naftës për litër, unë e voziti veturën time private dhe i qes naftë vetë nuk i qes naftë prej komunës në kuadër të këtij shpenzimi hynë zjarrfikësa, pylltaria, spitali, si dhe ndihmat në shëndetësi me karburant, mos akuzo këto janë akuza të pa baza të lutem kujdes fjalorin.

Osmon Sadikaj - mos të ngutemi të bëjmë paragjyqime të dhamë një opinion mëditjet brenda dhe jashtë vendit janë për shkak të kodit ekonomik nga thesari ne i paguajma transportin e nxënësve brenda për brenda komunës. Kontingjente është qytetaret që e padisin komunën rasti konkret është së ne vitin 2001 ose 2002 kur e ka privatizuar fabrikën e tepihëve dhe sipas këtij investimet që i ka bërë ky në atë fabrikë janë 250 mijë euro dhe po kërkon me ja kompensuar jo borxhe siç thatë ju se ky është një paragjykim shumë i ranë për qytetaret me pas kujdes.

Niman Beqiraj – të këto borxhet duhet të jepni me shumë sqarim unë e flas vetëm këtë që shkruhet këto asgjë ma shumë.

Ajshe Metaj – borxhet që komuna i kanë të tjerët e kam shqyrtuar një tabelë që komuna ju ka ndihmuar disa nga familjeve me nevojë. Departamenti i arsimit detyrimet konti gjentekane qen për paga jubilarë, shujtat, pagat e udhëtimit, si dhe pagesa tjera.

Florin Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kryesues kam një vërejtje për ju që të mani rend që ne kur ta marrim fjalën të mund të diskutojmë, kryetari e asamblistë e kanë një dëre sepse ne flasim edhe politikisht port zyrtari financiar nuk ka drejt me na jep vërejtjes as kërcenim ne. Tjera here kur të del zyrat jashtë kompetencave të veta ja ndërpret fjalën. Sa i përket suficitit foli në emër të VV edhe Nimani unë deshta vetëm me e nda me ju një përvojë që e pata ka erdha rrugës të memoriali Ibrahim Rugova një

numër i madh i qytetarëve mbushin ujë të mbi vadave e këtu na kanë tepruar mbi 1 milion euro.

Kryesuese i Kuvendit - e di që ndonjëherë kam toleruar me shumë se sa me lan lejuar legjislacioni të fuqi mirë po të gjithë duhet të kontribuojmë që të kemi një debat sa me të mirë, dhe kontributdhenës.

a ka dikush diçka,

Pasi që diskutime tjera nuk ka

Hedh në votim

Miratohet me 18 vota për, dhe 5 kundër

Të pranishëm 23 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken radhës , Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private.

Drejtori për Kadastër dhe Gjeodezi, z. Agon Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Propozim - Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private.

Nexgjdet Ramaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, a jeni marr vesh paraprakisht para se me filluar punimet në atë zonë me pronarin e pronës private, sepse ne e dim që punimet janë ndërprerë nga pronari i tokës. Këtu po ceket se sa po merret pronë por sa po ja jepni nuk po tregoni. Po dihet që do ta vlerësoj Ministria përkatëse.

Kryetari i Komunës - ne e kemi bere një marrëveshje me Ismetin por aj e ka prish marrëveshjen ka shkuar në polici, jemi takuar prape me Ismetin vjen komisioni i certifikuar nga Ministria dhe e bën vlerësimin e i tregon se sa i takon kompensimi. Nëse aj nuk pajtohet me vlerësimin nga ministria ka të drejt të bej ankesa në instanca tjera dhe vazhdojnë me procedura tjera. Këtu e kem kësen e parashtruar nga pronari i asaj pronës për kompensim dhe ne konform kësaj kërkesë kemi reaguuar.

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka?

Pasi që diskutime tjera nuk ka

Hedh në votim

Miratohet me 22 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim

Konstatohet që 24 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Korrigjimi i Planit të Veprimit për Transparencë.

Drejtori Administrat, z. Arben Kabashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Korrigjimi i Planit të Veprimit për Transparencë.

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka?
Pasi që diskutime tjera nuk ka
Hedh në votim
Miratohet me 24 vota për, 1 kundër
Konstatohet që 25 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e shtatë e rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit të nenit 3 të Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.

Drejtori për Urbanizëm dhe Mjedis, z. Dukagjin Hoxha - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Plotësimit të nenit 3 të Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoha.

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka?
Pasi që diskutime tjera nuk ka
Hedh në votim
Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje
Konstatohet që 25 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës, Plotësimi i emrit të projektit "Ndërtimi i Infrastrukturës së Jashtësme në shkollën "Mithat Frasheri" në Gurrakoc " me emrin e ri të projektit "Ndërtimi i Infrastrukturës së Jashtme, Fasadimi, Ndërrimi i Dyerve dhe Dritareve në shkollën "Mithat Frasheri" në Gurrakoc".

Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati - bën prezantimin dhe sqarimin e

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka?
Pasi që diskutime tjera nuk ka
Hedh në votim
Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje
Konstatohet që 25 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e fundit Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Valbone Demaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë ju lutem pa keqkuptime, mos të ofendojmë të gjithë asamblistët koleg këtu kur të bëjmë pyetje këtu të mos bëjmë komente se po me duket po dalim shumë keq në opinion.

Niman Beqiraj - i kam 5 pyetje, pyetja 1 për QKMF-në sipas projektit kapitale të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022 janë ndarë 2 milion e 100 mijë euro e në vitin 2023 janë ndarë 1 milion e 100 mijë euro si granatë për Istogun e që duhet të përfundoj në 2024, pyetja është se kur do filloj praktikisht dhe kur do të përfundoj ky në mënyrë që ne të shohim cilat janë problemet që na ka ndalur dhe si do ta përfundoni këtë punë. Shkolla e Kashicesh është e mbushur me dele e me kingja. A e keni mendje me e lye dhe me ja ndërruar ato dyer e dritare në mënyrë që fshati me e përdorur për nevojat që i ka si shtëpi të kulturës.

Orari i çerdheve në Istog për shkak që orari i punës është deri në 4 e çerdhet e përfundojnë orarin e prindërit nuk arrijnë me i marr fëmijët a ka mundësi që orari të zgjatët deri në ora 16:30.

Rruga Jeta në fshatin Serbobran janë dikund 15 shtëpi rrugë e ka gjatësinë 300 ose 350 m është një kosto e vogël për Komunën, është e një rëndësie të madhe për atë pjesë, kur është në plan asfaltimi i kësaj rruge.

Pyetja e fundit për stacionin e Autobusëve, një here e keni prur me subvencionuar në mënyrë që edhe ata punëtor aty që punojnë me i mor pagat nuk kanë mor rroga gati dy vite . Çka është në plan me u bë me Stacionin e Autobusëve.

Kryetari i Komunës – për Spital është amandamentuar që prej se kam qen deputet fatmirësisht po vazhdon me mbetur pjese e buxhetit të Republikës së Kosovës është dorëzuar projekti janë kërkuar një mori ndryshimesh në projekt konfirmo standardëve spitalore arkitekti është duke i përfunduar dhe mendoj që brenda gjysmës së muajit të ardhshëm veç dorëzohen në ministrin, pastaj është çështje e tyre që vazhdojnë me procedurat e prokurimit.

Orarin e çerdheve do ta diskutojmë bashke me drejtorin e arsimit edhe drejtoreshat e çerdheve të shohim çka mund të bëjmë.

Rruga Jeta është në projekt buxhet.

Stacioni i Autobusëve është me drejtorin e Shërbimeve Publike tash pasi që të jetë tregu aty besoj se do të funksionalizimet edhe stacioni i Autobusëve.

Liridona Lajqi Avdiaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, po ndërlihdhna me temën me herët të Nimani nuk është hera e parë që Nimani del jashtë temave të diskutimit dhe është për keqardhje niveli i tij i të shprehurit. Dha pata një pyetje për ju kryesues a ka ndonjë rregullore që i kufizon apo i parandalon pak këto diskutime se nuk jemi të obliguar me e ngu atë nivel, këtu dëgjohemi nga shumë persona shumë familjar dhe është niveli shumë i ulët i të shprehurit tina duhet të ketë ose me shumë kujdes ose ti ketë me të kufizuar.

Niman Beqiraj – nuk kam ardh këtu në asamble për me i pëlqyer dikujt, as nuk vi me kalkulim a fitoj vota a hupi unë kam folur çka kam parë këtu, në media është dal që shkolla e Kashicesh është shfrytëzuar nga delet e kingjat çka ka të keqe këtu.

Liridona Lajqi Avdiaj – nuk e kam asgjë personale me askënd këtu por fjalën fallugja që po me vjen keq edhe me e përmend nuk besoj që e ki ndi ose lexuar dikund siç e ceke, mos e kthe pyetjen ku po të konvenon ty.

Ajshe Metaj – pyetja nga drejtori i shërbimeve publike z. Abedin Kabashi Bust stacionet në fshatin Cerrcë i cili është zhvendosur se ka qen një here para atij objekti që është duke u ndërtuar në Cerrcë ajo fabrika e ujit apo çka është ajo është qitur në skain tjetër të rrugës por është dëmtuar dhe nuk mund të shfrytëzohet a mundet me u reparu ajo. Dhe a është legalizuar aj objekt aty a i plotëson kushtet.

A ka riparime të rrugëve sepse janë dëmtuar shumë si pasoj e reshjeve të Trofta dhe në Cerrcë ka edhe dëmtime tjera por këto janë me të mëdhatë

Abedin Kabashi Drejtor i Shërbimeve Publike – bust stacionin e ka prishur era, kontrata ka përfundua aktiviteti ka qen i vogël, të gjitha bust stacionet janë riparuar janë ngjyrosur u be ndërrimi i materialeve drurore edhe çka ka pasur nevojë. Dëmtimet neper rrugë kemi lidh kontratën e re 2vjeqare është kompania lokale që e ka marrë besoj që këto dit do të fillojnë me proces.

Kryetari i Komunës – fabrika në fshatin Cerrc është investim i jashtëm direkt pëlqimin e merr nga Ministria përkatëse, lejen e ndërtimit e ka, lejen e përdorimit ende nuk e ka sepse nuk e ka filluar punën.

Arta Balaj – matja për kanalizimin në lagjen Balaj është bere janë ndarë 20mijë euro për ketë vite por këto mjete nuk na mjaftojnë për ndërtimin e kanalizimit në lagjen Balaj sepse është premtuar se ka me u përfunduar krejt gjatë vitit 2023, ne kemi problem edhe me kanalin e ujitjes dhe të gjitha ujërat e zeza po derdhen aty dhe është një tmerr me e parë, prandaj kërkoj nga ju që të behet edhe matja e kanalizimit në Llukafc të Begut dhe me jetët e ndara që janë 60mijë euro të vlerësohet edhe një here edhe në Lluga dhe Llukafc të Begut të punohet kanalizimi komplet e jo vetëm një pjesë. Po ashtu kërkoj që gypi i kanalizimit të jetë F250 dhe të jetë funksional për të dy fshatrat.

Abedin Kabashi Drejtor i Shërbimeve Publike – kam qen në vend të ngjarjes është bere matja, Lagja Balaj kryhet por mbetet pjesa nga pompa e benzinës, sepse nuk ka mundësi me u përfshirë me këto mjete që janë, besoj se me disa mbetje do ta realizojmë edhe pjesën që do të mbetet.

Agron Gashi – kam një kërkesë nga banoret e fshatit Tomoc rruga “Kushtrimi i Lirisë” thonë se dikush privatisht e ka ngushtuar lumin duke hedhur mbetje inerte, fshataret thonë që kanë ber kërkesën është rrezik dalja nga shtrati e atij lumi, Lumi me kadastër thuhet që është 12 metra , tani është dy metra prej atyre ndërtimeve që i kanë bere dhe mbetjeve që i kanë gjuajt afër lumit kështu se ata e shohin si rrezik gjatë të reshurave me dal shtrati nga lumi me pas vërshime ka dame edhe me të mëdha për shkak të një neglizhence.

Negjdet Ramaj – kam disa pyetje i kam dorëzuar disa here me shkrim disa pyetje por as një here nuk kam marr përgjigje. Kam një pyetje nga shoqata e gjuetarëve deri ku ka ardhur vendimi për gjuetinë?

Astrit Hajrizaj, Drejtor i Bujqësisë Pyltarisë dhe Hidroekonimi – ne kemi anuluar një vendim këtu në Kuvend i cili e ka përfshirë komplet territorin e Istogut si vendgjuetisë. Ne tash fillimisht duhet të bëjmë elaboratin dhe ta bëmë në kuvend për hapat e mëtejshëm.

Negjdet Ramaj – dua ti bej pyetjet kryetarit, pyetja 1 ujësjellësi i mbi vadave qytetaret duan ta din sakt deri ku kanë arritur punimet.

Kërkesë nga Fshatrat Cerkozë dhe Sorigan, banoret jetojnë në kushte të vështira pa rrugë kanalizim, rrjet elektrik të dëmtuar a ka mundësi me dit se a kini ndonjë planë që të përmirësohet jeta në këto fshatra, duhet të gjeni mënyra që ti stimuloni me subvencione ose grande banoret e mbi vadave që ata të kenë arsye të qëndrojnë në ato fshatra. Mbivada ka qen dhe po mbetet një zonë e harruar nga Komuna, dihet se Rakoshi është qendër urbane sikur Vrella, Gurrakoci dhe Banja, mirë po nuk ka investime kapitale në Rakosh, unë si zë i qytetarëve që vi nga pjesa e mbi vades kërkoj nga ju që ta ndërtoni një park në bashkësinë lokale në Rakosh që banoret e asaj zone të kenë ku të dalin me fëmijët e tyre për shëtitje dhe argëtim.

Kryetari i Komunës – ujësjellësi është punimet veç se kanë filluar date nuk dha më deri të shohë që u lëshuar uji, ka pasur komplikime ka pasur ndryshime nga ana e kontraktorit banka e Austrisë ka pasur ndryshim mbikëqyrësit për shkak të problemeve që i ka pas sigurisht kjo ne nuk na liron nga përgjegjësia por e di së kaptazha ka përfunduar e di që rryma në stacionet e tubimit ka shkuar, 70% e pjesëve të pompimit janë instaluar, e di se kanë mbetur ditë pune deri sa të vijën deri të dizinfektimi dhe testimi i presionit të gypave dhe lëshimi i ujit.

Cerkolezin dhe Soriganen nuk po mendoj që jemi duke e len anash, ka pas rrugë të asfaltuara ka pas kanalizim të ndërtum. Ka pas rrugë të shtruar në Rakosh komplet bashkësia e Rakoshit me fshatrat për rreth e komplet mbi vaden është e prekne bile është e prekne komplet pjesën tjetër e fshatrave të qytetit të Istogut, janë mbetur disa rrugë të vogla pa përfunduar të cilat se shpejti do të kryhen edhe ato.

Nexhdet Ramaj – transporti publik është problemi kryesor mbivada, vetëm transporti i nxënësve që është në 8 mëngjes dhe 13 ora pasdite. Dhe lagja Sadriaj në Cerkozë kanë problem me kanalizim.

Kryetari i Komunës – jam i njoftuar me problemin e lagjes Sadriaj, kam komunikim të rregullt me ta. Pjesa e transportit është problem me pas kompani urbane lokale e kishim dërguar atje.

Lavdiqe Bujupaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një pyetje dy punëtor teknik në shtëpinë e kulturës të cilëve kontrata e punës nuk ju ka vazhduar, sipas informatave që kam kanë punuar me vite dhe gjashtë muajt e fundit kanë punuar pa pagës. Sepse gjendjen Ekonomike familjarë nuk e kanë të mirë.

Kryetari i Komunës – po Lavdiqe janë 3 jo dy dhe është e pamundur me ju premtuar vende pune sepse po flasim për konkurse publike, kontrata ju ka përfunduar dhe nuk kemi të drejt ligjore që ti vazhdojmë kontratat mbi vepër. Do shohim çka mund të bëjmë për ta.

Hajrush Shoshi – sqarim për shkollën në fshatin Kashicë, në mungesë të nxënësve është mbyllur shkolla. Objekti si objekt nuk është interes i fshatit, kam tentuar që atë objekt ta shfrytëzojmë për qëllime të fshatit por nuk janë të interesuar. Palestra e sportit në Vrellë bile kulmi të mbulohet sepse prishet ndërtimi me drunjë kur të behet rishikimi i buxhetit të ndahen mjetet.

Florin Dreshaj – shkolla në fshatin Prigod, punëtori ndihmës aty është konflikt familjar tash, shpresoj të reagoni që mos të ndodhë ndonjë problem. Rastin e njëjtë e kemi edhe në Kaliqan ata Pacajt që e kanë lëshuar shkollën. Tash ti drejtor po ki dëshirë me e prur burrin e motrës me e shti aty por dije që nëse insiston ka me të dal problem.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush tjetër diçka ?

Falënderon të gjithë për durimin qe patën, dhe kontributin e dhëne,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:45

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova